



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Pranuar - Primjeto M/Dang <i>01-02-2011</i>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
<i>01-013/96</i>			-

Në mbështetje të nenit 12.par.3, nenit 52.par.2 dhe 58. Pika g.dhe h. të Ligjit për vetqeverisje lokale Nr.03/L-040 (G.Z e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në bazë të nenit 22 par.2 të Statutit të Komunes së Vitisë Nr. 02-013/5165 të datës 18.11.2008 si dhe konform rekomandimit të Komitetit për Politik dhe financa të Kuvendit të Komunes së Vitisë dt. 21.01.2011, Kuvendi i Komunes së Vitisë në seancën plenare të datës 31.01.2011.miraton këtë ;

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E INICIATIVËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË, PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTSIMIN E DISPOZITAVE TË STATUTIT TË KOMUNËS SË VITISË

I

-MIRATOHET- Iniciativa e kryetarit të Komunës së Vitisë për ndryshimin dhe plotsimin e dispozitave të Statutit të Komunës së Vitisë –STATUTIT-Nr.013/5165.të datës 18.11.2008.

II

Ndryshimet dhe plotsimet në Statutin e Komunës së Vitisë do të bëhen në pajtim me LVQL, Ligjin për Kufijt Administrativ, Ligjin për Sherbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në pajtim me Rregulloren e Qeveris së Kosovës Nr.02/2010

-Ndryshimet dhe plotsimet në Statutin e Komunës së Vitisë mund të prekin edhe normat tjera të Statutit me qëllim të precizimit dhe harmonizimit të tyre ligjor dhe terminologjik

III

Ndryshimet dhe plotsimet në Statutin e Komunës së Vitisë do të bëhen nga komisioni i cili do të formohet me Vendim të veçant të Kuvendit të Komunës së Vitisë i cili komision do të përbëhet nga përfaqësuesit e Subjekteve politike të përfaqsuara në Kuvendin e Komunës së Vitisë dhe nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetit .

IV

Pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Vitisë, propozimi për ndryshimin dhe plotsimin e Statutit do të jetë në diskutim-konsultim publik, në një afat prej 30 dite.

V

-Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Administratë dhe personel.

VI

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Më 31.01.2011
Viti

*Kryetari i Kuvendit të Komunës
së Vitisë*



Skenderbe Hebibi

Skenderbe Hebibi